



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRI

URDHËR

Nr. 745 datë 1.2.2017

PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E NJOHJES SË UDHËRRËFYESIT TURISTIK TË NDERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 62 pika 3 të ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin":

URDHËROJ:

1. Mundësimin e ushtrimit të veprimtarisë si udhërrëfyes turistik të nderit në Republikën e Shqipërisë, për një periudhë të kufizuar kohe, për shkencëtarë të shquar dhe ekspertë nga fusha të caktuara, si dhe profesionistë në fushën e udhërrëfyesve të dalë në pension, duke aplikuar pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin për t'iu njohur cilësia e udhërrëfyesit turistik të nderit.
2. Ministria përgjegjëse për turizmin njeh cilësinë e udhërrëfyesit turistik të nderit duke lëshuar certifikatën përkatëse të udhërrëfyesit turistik të nderit.
3. Cilësia e udhërrëfyesit turistik të nderit mund t'u njihet:
 - a. Shkencëtarëve të shquar me kontribut dhe ekspertëve nga fusha të caktuara;
 - b. Profesionistëve në fushën e udhërrëfyesve, të dalë në pension me një eksperiencë pune si udhërrëfyes turistik në Republikën e Shqipërisë prej të paktën 20 (njëzet) vitesh.
4. Çdo person që aplikon për pajisjen me certifikatën e udhërrëfyesit turistik të nderit duhet të dorëzojë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin një kërkesë, e cila duhet të përmbajë:
 - a. të dhënat identifikuese, adresën dhe kontaktet e personit;
 - b. një përshkrim të detajuar të veprimtarisë/ngjarjes për të cilën kërkohet pajisja me certifikatë.
5. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Fotokopje të letërnjoftimit ose pasaportës;
 - b. Fotokopje e titullit shkencor ose dokumentin që vërteton eksperiencën e punës si udhërrëfyes turistik dhe daljen në pension;
 - c. Vërtetimin e pagesës së tarifës së aplikimit në shumën 500 (pesëqind) Lekë;

ç. Dy fotografi.

6. Për shqyrtimin e kërkesës për pajisje me certifikatën e udhërrëfyesit turistik të nderit, Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike (“Komisioni”) pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin merr opinionin e Shoqatës Kombëtare të Guidave Turistike të Shqipërisë, e cila duhet të përgjigjet me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve. Komisioni shqyrton kërkesën e dorëzuar dhe merr vendim për pajisjen ose jo të kërkuesit me Certifikatën e udhërrëfyesit turistik të nderit, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës.
7. Në qoftë se kërkesa nuk është paraqitur në përputhje me pikat 4 dhe 5 më sipër, ministria përgjegjëse për turizmin i kërkon kërkuesit me shkrim korrigjimin e pasaktësive brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës dhe i cakton kërkuesit një afat për plotësimin e pasaktësive.
8. Në rast se Komisioni miraton kërkesën, certifikata e udhërrëfyesit turistik të nderit, e nënshkruar nga Ministri, i jepet kërkuesit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e vendimit të Komisionit.
9. Certifikata përmban të dhënat e mëposhtme:
 - a. Emrin dhe mbiemrin, të shoqëruar me foto;
 - b. Datën e lëshimit të certifikatës;
 - c. Afatin e vlefshmërisë së certifikatës prej një viti.
10. Në rast se Komisioni nuk miraton kërkesën për pajisjen me certifikatë, vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë arsyet e refuzimit të kërkuesit për pajisjen me certifikatë. Vendimi i Komisionit i njoftohet kërkuesit brenda 5 ditësh. Ankimi ndaj vendimit të Komisionit i cili refuzon kërkesën për pajisje me certifikatë, bëhet në gjykatën administrative të shkallës së parë, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
11. Asnjë person nuk mund të veprojë si Udhërrëfyes Turistik Nderi, ose të përdorë emërtimin “Udhërrëfyes Turistik Nderi” në Republikën e Shqipërisë, nëse nuk është pajisur me certifikatë sipas këtij Urdhri.
12. Certifikata e udhërrëfyesit turistik të nderit lëshohet për kohëzgjatjen e veprimtarisë për të cilën kërkuesi kërkon të pajiset me certifikatë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë brenda një viti. Udhërrëfyesi turistik i nderit nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e udhërrëfyesit më shumë se 30 (tridhjetë) ditë brenda një viti. Ai detyrohet të njoftojë me shkrim Ministrinë përgjegjëse për turizmin për çdo tur gjatë të cilit do të veprojë si udhërrëfyes, si dhe për kohëzgjatjen e tij.
13. Detyrat dhe përgjegjësitë e udhërrëfyesit turistik të nderit janë ato të përcaktuara në Kreun IV të Rregullores “Për kriteret për pajisjen me certifikatë, për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre” të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

14. Ngarkohet Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike dhe Inspektorati përgjegjës për turizmin për zbatimin e këtij urdhri.
15. Urdhri nr. 8345, datë 18.10.2016 “Për kushtet dhe mënyrën e njohjes së udhërrëfyesit turistik të nderit” shfuqizohet.
16. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

MILVA EKONOMI



The stamp contains the text: REPUBLIKA E SHQIPËRIE, MINISTRI I TËRËMBIT, DHE TURIZMIT, TIRANË.